



**Office of The Auditor General  
Zyra e Revizionit Gjeneral  
Kancelarija Generalnog Revizora**



**Nr. i dokumentit: 21.0.1-2006-08**

**RAPORTI FINAL I AUDITIMIT MBI PASQYRAT  
FINANCIARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31.12. 2006**

**Prishtinë, Gusht 2007**

## PËRMBAJTJA

	Përmbledhje e përgjithshme	3
<b>1</b>	<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
1.1	Korniza e auditimit	4
1.2	Fushëveprimi i auditimit në Kuvendin e Kosovës për vitin 2006	4
1.3	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)	4
1.4	Struktura e raportit	6
<b>2.</b>	<b>Raportimi i të dhënave financiare</b>	<b>6</b>
<b>3.</b>	<b>Çështjet që ndikojnë në dhënien e opinionit</b>	<b>6</b>
3.1	Opinionit i Auditimit	7
<b>4.</b>	<b>Sistemi i Kontrollit të Brendshëm</b>	<b>7</b>
<b>5.</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>8</b>
5.1	Paga dhe mëditje	8
5.2	Mallra shërbime dhe Investime Kapitale	9
5.3	Avanset	10
<b>6.</b>	<b>Menaxhimi i Pasurisë</b>	<b>10</b>
<b>7.</b>	<b>Subvencione dhe transfere</b>	<b>11</b>
<b>8.</b>	<b>Implementimi i Rekomandimeve nga viti 2005</b>	<b>12</b>
	<b>Aneksi 1: Te gjeturat, ndikimet dhe rekomandimet</b>	<b>13</b>
	<b>Aneksi 2: Komentet e entitetit dhe përgjigjet e ZRP-së</b>	<b>22</b>

## **Përmbledhje e përgjithshme**

Auditimi i pasqyrave financiare të Kuvendit të Kosovës (KK) është kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZRP).

- Opinioni i dhënë lidhur me llogaritë është i kundërt për shkak të çështjeve të paraqitura në seksionin 3. Pjesa më e madhe e paqartësive rrjedhe nga pagesa e partive politike përmes subvencioneve dhe transfereve, për të cilat raportet financiare nuk kanë qene të përgatitura në mënyrën adekuate, (në kemi vërejtur këtu se partitë politike janë po ashtu një subjekt shqyrtimi nga ana e (OSBE). Po ashtu janë vërejtur çështjet lidhur me kalkulimin jo të saktë të shkallës tatimore, të pushimit mjekësor, të dhënat e personelit, pagat dhe mëditjet, tejkalimi i ditëve të paautorizuara për udhëtime jashtë vendit, si dhe dobësitë në zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/3 dhe të Ligjit nr. 2003/17 të Prokurimit Publik.

Në aneksin 1, auditori i paraqet 22 të gjetura me ndikimet dhe rekomandimet lidhur me të gjeturat. ZRP-ja do të kërkonte nga menaxhmenti i lartë i entitetit që të ndërmarre një veprim korrigjues lidhur me rekomandimet, para së gjithash ta paraqesë planin e veprimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit final të auditimit.

### **1. Hyrje**

Duke u bazuar në nenin 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9 Mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë si dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 mbi themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë nenin 3.2 dhe 4.4. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosove ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Kuvendit të Kosovës për periudhën prej 01. janar. 2006 deri me 31. dhjetor. 2006.

## **1.1 Korniza e auditimit**

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/18 më datë 04 tetor 2002, krijon bazën ligjore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në Kosovë. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, nga Auditori i Përgjithshëm (AGJ) kërkohet që ta kryej auditimin e rregullt vjetor për të gjitha institucionet e Kosovës, duke përfshirë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përkatësinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të zbatuara në kuadër të institucionit ose të entitetit që iu është nënshtruar auditimit; si dhe
- Të gjitha çështjet të cilat dalin ose kanë të bëjnë me auditimin;

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës e ka nxjerr Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 2003/2 (LMFPP), i cili ligj edhe formalisht është shpallur nga PSSP- me Rregulloren nr 2003/17 të datës 12 maj 2003.

## **1.2 Fushëveprimi i auditimit në Kuvendin e Kosovës për vitin 2006**

Objektiva primare e këtij auditimi është që t'i mundësohet ZAGJ-së që ta japë opinionin nëse pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për shpenzimet e kryera gjatë vitit i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2006, si dhe nëse janë përgatitur në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP) lidhur me "raportimin financiar sipas kontabilitetit të parasë së gatshme". SNKSP-të janë nxjerr nga Bordi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

## **1.3 Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA)**

Pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin 2006 kanë qenë subjekt i auditimit të pavarur i cili është realizuar në pajtim me SNK-të e Bordit të standardeve ndërkombëtare të auditimit, i cili funksion si organ i veçantë në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) të standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për sektorin publik. Këto standarde e përcaktojnë kornizën ndërkombëtare sipas së cilës Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i kryejë detyrat dhe t'i përfshijë çështjet siç janë, parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rrezikut dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve dhe konkluzionet si dhe raportimi i auditimit.

Standardi i caktuar Ndërkombëtar i Auditimit që përcakton konkluzionet e auditimit dhe të raportimit, siguron formën dhe të shprehurit standard i cili

duhet të adoptohet kur një auditor jep një opinion të qartë ose të pandryshuar të auditimit, si dhe udhëzojnë se kur një auditor duhet të japë një opinion të kualifikuar ose të modifikuar të auditimit.

Një opinion i modifikuar i auditimit duhet të jepet për këto situata vijuese:

- kur auditori vjen në përfundim që sipas të dhënave të marra të auditimit, pasqyrat financiare nuk janë pa gabime materiale për shkak të mospajtit me Menaxhmentin lidhur me (i) pranueshmërinë e politikave të zgjedhura të kontabilitetit, (ii) zbatimin e politikave të zgjedhura të kontabilitetit ose (iii) përshtatshmërinë e shpalosjes në pasqyrat financiare. Prandaj, auditori vjen në përfundim që pasqyrat financiare nuk janë përgatitur nga të gjitha aspektet në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; apo
- kur auditori nuk mund të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të arritur në përfundim që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Pas kësaj, auditori e jep gjykimin profesional lidhur me materialitetin dhe shtrirjen e ndikimit të çështjes duke i dhënë rëndësi ndryshimit për marrjen e vendimit lidhur me llojin e opinionit i cili duhet të lëshohet, si në tabelën më poshtë:

<b>Natyra e çështjes e cila i jep rëndësi ndryshimit</b>	<b>Ndikimet ose ndikimet e mundshme të pasqyrave financiare</b>	
	<b>Materiale</b>	<b>Materiale dhe ndikuese</b>
Mospajtimi me udhëheqjen	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
Pamundësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse	Opinion i kualifikuar	Refuzim i opinionit

Nga kjo rrjedh që refuzimi i opinionit lëshohet atëherë kur auditorët nuk mund të përcaktojnë nëse zërat e renditur në pasqyrat financiare janë apo mund të jenë të ndikuara nga pamundësia e tyre për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse dhe për shkak që është vështirë ose e pamundur për ata që t'i përshkruajnë qartë ndikimet lidhur me pasqyrat financiare në raportet e tyre të auditimit.

## **1.4 Struktura e raportit**

Hyryja në kaptinën 1 shoqërohet me kaptinat vijuese të cilët shtjellojnë këto pika:

- Kaptina 2 Raportimi i të dhënave financiare
- Kaptina 3 Çështjet që ndikojnë në dhënien e Opinionit
- Kaptina 4 Sistemi i kontrollit të brendshëm
- Kaptina 5 Shpenzimet
- Kaptina 6 Menaxhimi i Pasurisë
- Kaptina 7 Subvencionet dhe transferet
- Kaptina 8 Implementimi i rekomandimeve për vitin 2005

Të gjeturat e hollësishme të auditimit të përfshira në raport janë ilustrime të çështjeve kyçe që janë gjetur gjatë auditimit të KK-së, por që nuk duhet të merren se mund t'i shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit.

## **2. Raportimi i të dhënave financiare**

Departamenti i Thesarit në MEF e ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 2006/14 mbi raportimin e organizatave buxhetore, me të cilin obligohen që ta paraqesin raporte financiare për parane e gatshme sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Afati i fundit për raportim ka qenë 31 janar 2007.

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrave financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin 2006. Këto pasqyra janë përgjegjësi e Menaxhmentit të Kuvendit të Kosovës.

## **3. Çështjet që ndikojnë në dhënien e opinionit**

Çështjet kyçe të cilat ndikojnë në opinionin e ZRP-së lidhur me pasqyrat financiare të entitetit janë si ne vijim:

- Sistemi i dobët i kontrollit të brendshëm në Kuvendin e Kosovës sidomos lidhur me regjistrimin dhe inventarizimin e pasurive si dhe mungesës së Njesisë së auditimit të brendshëm;
- ZRP-ja ka vërejtur disa mangësi lidhur me zbatimin e Ligjit të Prokurimit Publik nr. 2003/17 i shpallur me rregulloren e UNMIKU-ut nr.2004/3

ZRP-ja atje ku ka mundësi synon që në bazë të dëshmimeve të dhëna ta përcaktojë sasinë e paqartësive dhe të gabimeve financiare në llogaritë e pa-audituar, të gjeturat janë paraqitur në aneksin 1, kryesisht lidhur me pagat dhe mëditjet, mallrat e shërbimet, menaxhimin e pasurisë, subvencionet e transferet, dhe

avancet. Këto të gjetura janë paraqitur dhe diskutuar me subjektin e auditimit si dhe janë inkorporuar korrigjimet dhe dëshmitë e tjera. ZRP-ja shfrytëzon rastin që t'ia paraqesë në hollësi udhëheqjes së lartë rekomandimet e bëra.

Tabela e paqartësive dhe gabimeve financiare	Shuma ne PF	Mos-pajtueshmëri me rregulloret, vlerësimi i shumës së tyre në PF	
		Paqartësitë	Gabimi
Te hyrat nga shërbimet	17,736	0.00	0.00
Shpenzimet			
- Pagat dhe mëditjet	2,273,346	2,127	2,127
- Mallrat dhe shërbimet	1,430,149	54,064	
- Subvencionet dhe transferet	1,899,987	1,091,748	
- Investimet kapitale	38,743	0	
<b>Totali</b>	<b>5,659,961</b>	<b>1,147,939</b>	<b>2,127</b>

Vëni re, që këto janë vetëm gabimet dhe paqartësitë të cilat janë kuantifikuar dhe se kjo tabelë përbën vetëm një pjesë të opinionit të përgjithshëm për entitetin.

### **3.1 Opinioni i Auditimit**

Për arsye të rëndësishme të çështjeve të përmendura në paragrafët e më poshtëm, ne e japim opinionin e kundërt lidhur me pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2006.

Pasqyrat Financiare nuk janë plotësisht të përgatitura në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të pranuar të sektorit publik për raportimin financiar të bazuar në para të gatshme si dhe kornizën ligjore në fuqi. Ka shume çështje serioze sa i përket menaxhimit të pasurive dhe mungesës së njësisë së auditimit të KK-ës të cilat kërkojnë vëmendje të menjëhershme nga udhëheqja e Kuvendit të Kosovës, Të gjitha këto janë paraqitur në aneksin 1.

## **4. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm**

Gjatë testimit të sistemit kontrollit të brendshëm kemi zhvilluar intervistat me menaxheret kryesor të Kuvendit të Kosovës, mirëpo Kuvendi i Kosovës nuk e ka të formuar njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2006 porë asë për vitet e mëparshme.

## **5. Shpenzimet**

Gjatë vitit 2006 Kuvendi i Kosovës prej 7,496,254 euro të planifikuara i ka shpenzuar 5,642,225 euro duke përfshirë pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet dhe shpenzime kapitale.

Ne tabelën e mëposhtme është paraqitur pasqyra e ekzekutimit buxhetor ne baze të linjave kryesore buxhetore.

Tabela e buxhetit të aprovuar dhe të shpenzuar për vitin 2006

<b>Emërtimi</b>	<b>Buxheti i aprovuar</b>	<b>Alokimet Buxhetore</b>	<b>L. K</b>	<b>P. F</b>
Paga dhe Mëditje	2,300,333	2,300,333	2,273,346	2,273,346
Mallra dhe Shërbime	1,283,505	1,283,505	1,430,149	1,430,149
Subvencione dhe Transfere	1,901,783	1,901,776	1,899,987	1,899,987
Shpenzimet Kapitale	1,840,633	1,703,133	38,743	38,743
<b>Totali</b>	<b>7,496,254</b>	<b>7,358,747</b>	<b>5,642,225</b>	<b>5,642,225</b>

Ne përgjithësi shpenzimet janë në kuadër të shumave buxhetore. Nga kjo tabelë, mund të shihet se ka mos planifikim të duhur të buxhetit, në veçanti tek shpenzimet kapitale, për arsye se janë planifikuar 1,840,633 euro ndërsa janë shpenzuar 38,743 euro dhe këto mjete janë bartur si suficit nga buxheti i mëparshëm.

### **5.1 Pagat dhe mëditjet**

Shpenzimet e pagave për vitin 2006 kanë qenë në shumë prej 2,273,346 euro. Kjo përfshin mbi 1 milion euro për Kompenzimet shtesë të cilat janë miratuar nga ana e Kuvendit.

Gjatë këtij auditimi kemi bërë rishikimin analitik për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ndërmjet raporteve të kuvendit, librit kryesor dhe listës së pagave "Payroll" për vitin 2006.

Përpos kësaj i kemi zgjedhur 10 mostra të dosjes së personelit nga regjistri i të punësuarve.

Në aneksin 1, ZRP i ka identifikuar disa të gjetura lidhur me pagat dhe mëditjet. Kuvendi i mban dosjet e personelit për të gjithë të punësuarit. Për disa të punësuar që janë pranuar nga shtylla e UNMIK-ut para prillit të vitit 2002, nuk janë aplikuar procedurat e rekrutimit, shpalljes së konkursit, intervistimit, selektimit, kriterëve për vlerësim etj.

Edhe mbase pranimit në punë nga vendoret ne kemi vërejtur se ka mungesë të kërkesës për rekrutim të kandidateve.

Tabela e shpenzimeve të pagave e mëditjeve dhe pagave shtese



Kod,e ko.	Emërtimi	L. K Paga Primar	L. K Kompenzimet shtese	L. K Gjithsej	P. F
11110	Pagat Neto	1,031,584		1,031,584	1,031,584
11120	Tatimi ne paga	82,237	130,224	212,461	212,461
11130	Kont e Punët	58,633	49,480	108,113	108,113
11140	Kont e Punë	58,633	49,480	108,113	108,113
11200	Pagesat për pune jashtë orarit shtese		468,459	468,459	468,459
11300	Mëditjet e delegateve në kuvend dhe tarifat e komisionit		344,616	344,616	344,616
<b>Total</b>		<b>1,231,087</b>	<b>1,042,259</b>	<b>2,273,346</b>	<b>2,273,346</b>

Ne aneksin 1, janë të identifikuar me gjerësisht të gjeturat tona.

Kryesia e kuvendit të Kosovës, me dt, 18 janar 2005, në baze të propozimit për buxhet dhe financa, në baze të rregullës 8.9, 8.11 dhe 10.6 si dhe aneksit nr.1. rregulla 3 dhe 4 të Rregullores së përkohshme të punës së Kuvendit ka nxjerre vendim:

“Për kompensimin shtese për deputet dhe stafin mbështetës të Kuvendit të Kosovës për vitin 2005”, ku ky vendim ka qenë në fuqi edhe për vitin 2006.

Këto mjete janë zotuar nga kodi 11200 dhe 11300,

Për kompensimet shtesë të vitit 2006 për punëtorët e administratës, nuk është aplikuar tatimi sipas shkallëve tatimore.

Nga 10 mostrat e audituara të punonjësve në administratën e Kuvendit të Kosovës, vlera e gabimeve Financiare është €151.93, ndërsa e paqartësive është 292.30 euro, mirëpo duke marrë një mesatare për të gjithë të punësuarit në administratën e Kuvendit të Kosovës vlera e gabimeve financiare në vitin 2006 rritet në vlerën prej 2,127euro.

## **5.2 Mallrat, Shërbimet dhe Investimet Kapitale**

Nga gjithsej popullacioni në shumë prej 1,468,892 euro i kemi zgjedhur 7

mostra në shumë prej 329,268€ose 22 % nga gjithsej popullacioni.

Në aneksin 1, ZRP-ja i ka identifikuar disa të gjetura për sa i përket mallrave dhe shërbimeve. Ekzistojnë disa shkelje të LPP-së, të cilat shpijnë në paqartësinë dhe gabimin financiar të llogarive të theksuara.

Te gjetura kanë të bëjnë me:

- Moszbatimin e planit dinamik dhe mos aplikimi i penaleve,
- Faturimi me i hershem se sa urdhërblerja,
- Anëtarët e njëjte në komisionin e hapjes dhe të vlerësimit

- Furnizimi me material me tepër se sa janë paraparë ne kontrate dhe materiali i blere qe nuk është paraparë ne kontrate.
- Mos aplikimi i kodeve adekuate ekonomike
- Mungon data e Komisionit për vlerësimin e ofertave

Këto te gjetura janë si pasoje e mungesës se kontrollit te brendshëm, dhe mosrespektim te LPP-së.

### **5.3 Avanset**

Rendësi e veçante gjatë auditimit të avanseve iu është kushtuar procedurës së llogaritjes dhe mbylljes se llogarive të tyre.

Shuma e avanseve te buxhetuara për vitin 2006 ka qenë 57,527 euro, ku 29,273 janë shpenzuar, ndërsa shuma e mbetur prej 28,279 euro është kthyer në llogarinë bankare të BKK-së. Për auditim i kemi zgjedhure tri mostra në bazë të gjykimit profesional.

Ne aneksin 1. ZRP-ja ka identifikuar këto te gjetura:

- Mos mbyllja e llogarive të avanseve
- Pagesa me e madhe për vizita jashtë shtetit pa vendim paraprak.

## **6. Menaxhimi i Pasurive**

Në aneksin 1, ZRP-ja i ka identifikuar 4 të gjetura lidhur me menaxhimin e pasurive. Të gjeturat i paraqesim ne vijim:

- Mos emërimi i zyrtarit te pasurisë
- Emërimi si zyrtarë të pasurisë pa vendim apo kontratë pune
- Mos deklarimi i tërë pasurisë në pronësi të Kuvendit të Kosovës
- Mos vlerësimi dhe zhvlerësimi i pasurisë

Kuvendi i Kosovës nuk e ka të emëruar udhëheqësin e pasurisë, sekretari permanent e ka angazhuar ne mënyre gojore një punëtorë i cili e kryen funksionin si zyrtarë i lartë për pagesa.

Gjatë auditimit që i është bërë Menaxhimit te Pasurive në Kuvendin e Kosovës, kemi ekzaminuar mënyrën e funksionimit të depos, procedurat e inventarizimit neper disa zyre, pasuritë e prezantuar ne pasqyrat financiare, vlefshmërinë e pasurive dhe zhvlerësimi i tyre.

Ne verifikimin e te dhënave te depos ne sistemin elektronik kemi vërejtur që menaxherja e depos përmban një program për te dhënat dhe evidencat qe i nevojiten për menaxhimin e depos, përmban te gjitha regjistrat e hyrje dhe daljes ne mënyre te kënaqshme si dhe një evidencë te mallit ne mënyre profesionale, ky sistem i mbajtjes së të dhënave ka ndodhur pas ndryshimeve te pozitive qe janë kryer në vitin 2006.

## **7. Subvencionet dhe Transferet**

Ne aneksin 1 kemi paraqiture ne mënyre me te përgjithësuar për ndikimet te gjeturat dhe rekomandimet.

Tabela e Raporteve për partitë politike te dorëzuara ne OSBE

Deklarimi i te ardhurave te Partive Politike për vitin 2006													
	PP	Raportet e Dorëzuara		Te ardhurat nga BKK-ja		Te ardhurat nga BKK-ja	Donacione		Tarifat e anëtarësimit		Te hyrat tjera		Gjithsej
		I-VI	VII-XII	I-VI	VII-XII	2006	I-VI	VII-XII	I-VI	VII-XII	I-VI	VII-XII	2006
1	LDK	PO	JO	372,432		744,865	4,198		4,694				753,756
2	PDK	JO	JO			475,446							
3	AAK	PO	PO	71,316	54,401	142,634							142,634
4	LPK	PO	PO			15,848	6,948	9,311	930	200			33,238
5	PSHDK	PO	PO	15,848	15,848	31,696							31,696
6	PD	PO	JO	7,933		15,848					700	1,000	17,548
7	KDTP	PO	PO	22,273	27,181	47,545							
8	IRDK		PO		31,500	31,696							31,696
9	PRBK	PO	PO	7,924	7,974	15,848							15,848
10	ORA	PO	PO	49,094	68,710	110,937							110,937
11	Koal.vaka	JO	JO			47,545							
12	SLKM	JO	JO			126,786							
13	GIS	JO	JO			31,696							
14	GIG	JO	JO			15,848							
15	PLK	PO		17,624		15,848	9,700		7,924				15,848
16	PDAK	JO	JO			15,848							
17	SDA	PO	PO	7,993	7,919	15,848			885	130	720	720	18,303
	GJITHSEJ					1,901,783							

Raportimi i Partive Politike është i rregulluar me nenin 19 te Rregullores 2004/11 ku secila parti politike duhet te dërgoje raportin vjetore ne zyrën e regjistrimit te partive politike ne OSBE për periudhat

- 01 janar deri me 30 qershor dhe
- 01 korrik deri me 31 dhjetor

Ne tabelën e mësipërme janë te paraqitura partitë politike qe i kane raportuar zyrës ne OSBE, shihet se.

- 9 parti i kane dorëzuar raportet e tyre financiare për 2006,
- 2 parti kane dorëzuar vetëm për një rën periudhe te vitit 2006
- 6 parti nuk kane dorëzuar asnjë raporte për vitin 2006

Tabela e Përqindjes se buxhetit te ndare nga BKK-ës për Partitë Politike dhe numri i deputeteve ne Kuvendin e Kosovës

	Partitë Politike	Përfaqësimi në Kuvend i deputeteve	% e pjesëmarrjes	Te ardhurat e ndara nga BKK-ja për partitë politike
1.	LDK	47	39.17 %	744,865
2.	PDK	30	25 %	475,446
3.	AAK	9	7.5 %	142,634
4.	SLKM	8	6.67 %	126,786
5.	ORA	7	5.83 %	110,937
6.	VAKAT	3	2.5 %	47,545
7.	KDTP	3	2.5 %	47,545
8.	PSHDK	2	1.67 %	31,696
9.	IRDK	2	1.67 %	31,696
10.	GIS	2	1.67 %	31,696
11.	LPK	1	0.83 %	15,848
12.	PD	1	0.83 %	15,848
13.	PRBK	1	0.83 %	15,848
14.	GIG	1	0.83 %	15,848
15.	PLK	1	0.83 %	15,848
16.	PDAK	1	0.83 %	15,848
17.	SDA	1	0.80 %	15,848
	<b>Gjithsej</b>	<b>120</b>	<b>100 %</b>	<b>1,901,784 €</b>

## **8. Implementimi i rekomandimeve nga ana e Menaxhmentit për vitin 2005**

Në bazë të informacioneve që kemi pasur gjatë auditimit tonë nuk kemi marruar dëshmi me shkrim që Menaxhmenti i ka implementuar rekomandimet e auditorëve për vitin 2005.

<b>Aneksi 1: Tabela e të gjetuarve</b>			
<b>Nr</b>	<b>Te gjeturat</b>	<b>Ndikimi</b>	<b>Rekomandimi</b>
	<b>2. Raportimi i të dhënave financiare</b>		
<b>1.</b>	<b>Mungesa e shpalosjes së pasurive jo-financiare</b> Gjatë auditimit kemi vërejtur se Kuvendi i Kosovës nuk e ka te emëruar udhëheqësin e pasurisë (zyrtarin e pasurisë) për vitin 2006. Nuk është bere e tere shpalosja e pasurive jo financiare ne pasqyrat financiare, këto shpalosje përfshinë pasuritë më vlerë mbi €1000, jetëgjatësia e të cilave e tejkalon një vit kalendarik.	Nga kjo kemi konstatuar që Kuvendi i Kosovës nuk i ka prezantuar të gjitha pasuritë në pasqyra financiare, e cila bie ndesh me nenin 16.2 të Udhëzimit Administrativ 2006/14 Raportimi i Organizatave Buxhetore, në të cilin kërkohet që në pasqyrat financiare të përfshihen të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1,000€	I rekomandohet Menaxhmentit sa me pare të bëjë regjistrimin e pasurive dhe ti paraqes te gjithë pasurinë ne pasqyrat financiare siç kërkohet me nenin 16.2 të Udhëzimit Administrativ 2006/14 lidhur me raportimin e organizatave buxhetore
	<b>4. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm</b>		
<b>2.</b>	<b>Auditimi i Brendshëm si një segment me rendësi ne kuadër të kontrollit të brendshëm nuk ekziston ne KK-ës</b> Kuvendi i Kosovës si organ kryesor ligjvënës nuk e ka te formuar njësinë e auditimit te brendshëm për vitin 2006, si dhe nuk ka pasure auditorë te brendshëm ase për vitet e mëparshme.	Auditimi i brendshëm është pjese e Kontrollit te brendshëm i cili i ndihmon institucionit në arritjen e objektivave me efektive dhe efikase, ne raport me të besueshëm financiar, dhe ne përputhje me ligjet dhe rregulloret. Po ashtu i ndihmon menaxhmentit në ruajtjen e pasurive si dhe në parandalimin dhe zbulimin e aktivitetit të mashtrimit.	Rekomandojmë Kuvendit te Kosovës qe sa me pare ta themeloje njësinë e auditimit te brendshëm duke definuar strukturën organizative dhe ndarjen e qartë të detyrave që do te kontribuonin në efikasitetin e entitetit. Gjithashtu Kuvendit të Kosovës i rekomandohet të zhvilloj dhe te dizajnoj një sistem adekuat të kontrollit brendshëm . Se pari te dokumentoj formalisht të gjitha politikat dhe procedurat e nevojshme te secilës zonë të përgjegjësi ne mënyre te kufizimit te paraqitjes se rrezikut operativ.
	<b>5.1 Pagat dhe Mëditjet</b>		
<b>3.</b>	<b>Mos aplikimi i kodeve adekuate ekonomike</b> Gjatë rishikimit te kodeve ekonomike kemi	Ne ketë rast Kuvendi i Kosovës nuk i ka respektuar kodet adekuate ekonomike, ka shfrytëzuar kodet e	I rekomandojmë Kuvendit të Kosovës qe te ju përmbahet kodeve adekuate ekonomike, të cilat janë te përcaktuara

	<p>vërejtur se ka mos zbatim të tyre. Kuvendi i Kosovës në bazë të rregullës 8.9, 8.11 dhe 10.6 dhe rregulla 3 dhe 4 të rregullores së përkohshme të punës së Kuvendit ka nxjerrë vendim, për kompensimin shtesë për deputet dhe stafin mbështetës të kuvendit të Kosovës, këto mjete janë zotuar nga kodet 11200 dhe 11300. Kodi 11200 është i përcaktuar për pagesat për punë jashtë orarit shtesat dhe stimulimet, dhe kodi 11300 është i përcaktuar për mëditjet e delegatëve në kuvend dhe tarifën e komisioneve. Nga këto kode janë shpenzuar të ardhura shtesë për punëtorët e administratës dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës.</p>	<p>përcaktuara për pagesat jashtë orarit dhe kodin për mëditje të delegatëve, nga kodi 11200 për pagat shtesë për vitin 2006 janë shpenzuar €468,459, ndërsa nga kodi 11300 janë shpenzuar €344,616.</p>	<p>nga MEF-ev, (thesari).</p>
<p><b>4.</b></p>	<p><b>Mos aplikimi i Shkalleve tatimore</b>  Për kompensimet shtesë të vitit 2006 për punëtorët e administratës nuk është aplikuar tatimi sipas shkalleve tatimore, ku pagat primare dhe kompensimet shtesë duhet të jenë në total të përbashkët dhe nga ky total të behet llogaritja sipas shkalleve tatimore. Personeli i administratës ka aplikuar tatimin në paga dhe në kompensime në mënyrë të veçantë duke mos e arritur shkallën e duhur të tatimeve.  Pagat shtesë nuk kanë kaluar përmes procedurave të payrollit por këto paga janë zotuar nga thesari dhe përmes bankës qendrore ju kanë shpërndarë punëtorëve nëpër bankat komerciale.  Nga 10 mostrat e audituara të punonjësve në administratën e Kuvendit të Kosovës, për moszbatim të procedurave të shkallës</p>	<p>Mos aplikimi i shkalleve tatimore ka si pasojë pagesën më të vogël të tatimit i cili ndikon që në buxhet të derdhen mjete më të pakta, çka nuk është në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/4 mbi tatimin e të ardhurave personale të ndryshuar me rregulloret 2003/3 dhe me rregulloren 2004/52, 8.1.b, ku kompensimet provizionet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjëseve mbi dhe përtej rrogës.</p>	<p>I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që të aplikoj shkallët tatimore ashtu siç kërkohet sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/3 Ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut 2002/4 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale dhe rregullores 2004/52 neni 8.1.b, për të ardhurat tjera personale.</p>

	tatimore vlera e gabimeve financiare është €51.93, duke marre një mesatare për te gjithë te punësuarit ne administratën e Kuvendit te Kosovës vlera e gabimeve financiare ne vitin 2006 ekziston ne vlerën prej €2,114.		
5.	<b>Pushimi mjekësore me pagese i lejuar me tepër se 15 dite kalendarik.</b> Gjatë auditimit të mostrave te zgjedhura nga dosjet e personelit kemi hasure se ka pasure lejim nga menaxhmenti i Kuvendit te Kosovës qe pushimi ti paguhet duke e tejkaluare 15 dite të vitit kalendarik..	Lejimi i pushimit me pagesë nga menaxhmenti për me shume se 15 dite kalendarik, është ne kundërshtim me udhëzimin administrative neni 22.1 Nr. MSHP/DASHC 2003/10 për zbatimin e Urdhëresës Administrative 2003/2, zbatimin e rregullores se unimkut NR. 2001/36 mbi shërbimin civil te Kosovës.	I rekomandohet Kuvendit të Kosovës qe ti përmbahet udhëzimit Administrative neni 22.1 Nr. Mshp/ Dashc 2003/10 për zbatimin e Urdhëresës Administrative 2003/2, zbatimin e rregullores se unimkut Nr. 2001/36, mbi shërbimin civil te Kosovës.
	<b>5.2 Mallra dhe Shërbime</b>		
6.	<b>Moszbatimi i planit dinamik dhe mos aplikimi i penaleve</b> Firma fituese N.T.H.S.R”SM KOMERC” e cila ka bere furnizimin me “Inventarë, tavolina pune, tavoline kompjuterike, rafte, karrika dhe sirtarë”, nuk ju ka përmbajte kohës se parapare (planit dinamik) sikurse është paraparë ne kontratë.	Nga kjo konstatojmë se mos aplikimi i penaleve për vonës te lifërimit nga kontraktuesi, mund te shkaktoj qe operatori ekonomik të mos i përmbahet afatit te liferimit, dhe një gjë e tillë ndikon ne mos efikasitetin e punës se këtij institucioni.	I rekomandojmë Menagjmentit te Kuvendit te Kosovës ne veçanti personave kompetente qe te bëjnë përcjelljen e përmbushjes se kontratës, dhe te marrin te gjitha masat ndëshkimore qe lejohen ne kontrate dhe ne LPP-ik ndaje kontraktorëve qe nuk i përmbahen kontratës ne tërësi.

7.	<p><b>Faturimi më i hershem se sa urdhërblerja</b></p> <p>Ne tenderin për “furnizime me pajisje te teknologjisë informative Llapto”, fletëporosia (Urdherblerja) është dërguar mbase pranimit te mallit respektivisht te faturës, fatura i përket dt, 17.11.2006, ndërsa fletëporosia është me dt, 27.11.2006 Ne tenderin për furnizim me “inventarë, tavolina, rafte, karrika, dhe sirtarë”, ne ketë raste fletëporosia është dërguar mbase pranimit te faturës, fletëporosia është dërguar me dt, 06.11.200, ndërsa fatura me dt, 09.10.2006.</p>	<p>Në asnjë rast fatura nuk mund ta ketë datën me te hershme se urdhër blerja për arsye se operatori ekonomik nëpërmjet urdhër blerjes informohet se cilat mallra është i obliguar ti sjellë e mbas këtij informimi ai e përgatit faturën</p> <p>Përpos kësaj një gjë e tillë bie ndesh me Rregulloret e thesarit 02 Mbi Shpenzimin e Parave Publike.</p>	<p>I rekomandohet Kuvendit te Kosovës se ne rastet për furnizim me mall, operatorit ekonomik duhet ti dërgohet urdhërblerja, para se ta dërgoje mallin, ne mënyre qe ky operatore (kontraktore) te jete ne dijeni për mallin te cilin do te ja ofroje entitetit.</p>
8.	<p><b>Anëtarët e njëjte ne komisionin e hapjes dhe te vlerësimit</b></p> <p>Ne tenderin për “<b>Sigurimin e automjeteve</b>” ku fitues është shpallure firma “Siguria” dhe vlera e kontratës është 18,860, ne përzgjedhjen e kësaj firme kane marre pjese anëtare te njëjte si ne komisionin e hapjes pore edhe ne atë te vlerësimit te ofertave.</p>	<p>Kjo nuk është ndarje e duhure e detyrave dhe shpie në konflikt të interesit. Të dy anëtarët e njëjte ne komisione nuk është në pajtim me kornizën ligjore.</p>	<p>I rekomandojmë Kuvendit te Kosovës t’i caktojë anëtarët e ndryshëm në komisione.</p>
9.	<p><b>Furnizimi me material me tepër se sa janë paraparë ne kontrate dhe materiali i blere qe nuk është paraparë ne kontrate.</b></p> <p>Ne lenden për “<b>Furnizim me material për zyre</b>” nuk janë te përfshire te gjithë artikujt e nevojshëm siç janë paraparë ne paramase (parallogarit) dhe si rezultat te kësaj ka pasur furnizime me material jashtë</p>	<p>Meqë furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës vijmë në përfundim që kontrata nuk është respektuar.</p>	<p>I rekomandohet Kuvendit të Kosovës qe te ketë një planifikim te duhure te shpenzimeve për furnizimin me material për zyre, ti përmbahet ne tërësi kontratës.</p>



	paramases se paraparë ne kontrate ne vlerën mbi 10 % te vlerës se kontratës. Kjo kontrate është lidhur ne vitin 2005 ne vlerë prej euro 5,874, dhe me kushte te njëjta sipas çmimit për njësi, është vazhduar edhe ne vitin 2006.		
<b>10.</b>	<b>Mos aplikim i kodeve adekuate ekonomike</b> Shpenzimet qe kane ndodhure për bileta te udhëtimit, janë regjistruar ne kodin 13140 i cili kode është i përcaktuar për mëditje jashtë vendit.	Regjistrimi i gabueshëm i kodeve ekonomike nuk është ne pajtim me udhëzimin administrativ nga MEF-ev për ndarje te kodeve ekonomike.	I rekomandojmë departamentit te financave te KK-së qe t'i zbatojë kodet adekuate ekonomike qe janë te përcaktuara nga thesari.
<b>11.</b>	<b>Mungon e data e Komisionit për vlerësimin e ofertave</b> Tenderi për “ <b>Mirëmbajtja dhe pastrimi i ndërtesës se Kuvendit te Kosovës</b> ” ne përzgjedhjen e kësaj kontrate, mungon data e komisionit për vlerësimin e ofertave, ku fitues i tenderit është shpallur kompania “AMM”, vlera e kontratës është EUR 9,954 për një vit.	Kemi te bëjmë me mos kompletim te dosjes se prokurimit	Dosja e prokurimit duhet të jetë e kompletuar.
	<b>5.3 Avanset</b>		
<b>12.</b>	<b>Mos mbyllja e avancave</b> Gjate auditimit për avancin e dhëne për “Udhëtim zyrtar ne Bruksel” është konstatuar se prej 9 personave te anëtareve te ekipit, vetëm 3 prej tyre e kane bere mbylljen e avancave, zyra e financave ne raportin vjetor i ka deklaruar të gjitha avanset si te mbyllura.	Kuvendi i Kosovës nuk ka vepruar ne pajtueshmëri me nenin 8.1 të Udhëzimit Administrativ 2006/12, në të cilin kërkohet që deri me më datën 15 dhjetor 2006 çdo organizatë buxhetore duhet ta bëjë mbylljen e avancave.	I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që ti përmbahet udhëzimit administrativ 2006/12 te thesarit për mbyllje te avancave vjetore.
<b>13.</b>	<b>Pagesa me e madhe për vizita jashtë shtetit pa ndonjë vendim shtese</b> Avanci i dhënë për “Udhëtim zyrtar ne	Pagesa me e larte pa ndonjë vendim shtese dhe qëndrimi me tepër se sa ka qen e planifikuar për vizitën ne Brazil	I rekomandohet personave përgjegjës te avancave qe të jenë në pajtim me kornizën ligjore dhe të

	Brazil"është aprovuar te zgjas prej 27.02.2006 deri 05.03.2006, por nga dëshmitë e ofruara ky udhëtim ka zgjatur deri me 07.03.2006 dy dit me shume se sa është aprovuar, dhe këto mjete janë kompensuar nga ana e kuvendit pa ndonjë vendim shtese.	është ne kundërshtim me planifikimin e bere për atë vizitë dhe vendimet e marruara për vizitën e bere.	kërkojnë"arsyetim te plote" për avanset e paplanifikuara.
	<b>6. Menaxhimi i Pasurisë</b>		
<b>14.</b>	<b>Mos emërimi i zyrtarit te pasurisë</b> Kuvendi i Kosovës nuk e ka te emëruar udhëheqësin apo zyrtarin e pasurive për vitin 2006 pore ase për vitet e mëparshme.	Kuvendi i Kosovës nuk iu ka përmbajtur nenit 3.3 të Udhëzimit Administrativ 2005/11 për emërimin e një zyrtari te pasurive.	I rekomandojmë menaxhmentit te Kuvendit te Kosovës, që të jetë në pajtim me kornizën ligjore për menaxhimin e pasurive.
<b>15.</b>	<b>Emërimi si zyrtar i pasurisë pa vendim apo kontrate</b> Sekretari permanent ne mënyre gojore ka emëruar si zyrtar te pasurisë personin i cili është si zyrtare i larte i pagesave, sipas pohimeve te këtij zyrtari ky është emëruar vetëm sa për te paraqiture gjendjen e pasurisë ne pasqyra financiare, dhe qe këto pasuri te jene te pranuar nga departamenti i thesarit. Me vendim te sekretarit i njëjti person ka qen i emëruar ne komisionin për regjistrim te pasurisë për vitin 2006.	Konstatojmë se sekretari permanent ka vepruar ne kundërshtim me rregullat dhe procedura te emërimit te personave ne mënyre gojore, si dhe te njëjtin person te emëruar ne komisionin për regjistrim te pasurisë, kjo ka te beje me mos ndarje te duhure te detyrave dhe konflikt te interesave. Kjo është ne kundërshtim me nenin 5.2 te udhëzimit administrative 2005/11.	I rekomandojmë menaxhmentit te Kuvendit te Kosovës, që të jetë në pajtim me kornizën ligjore për menaxhimin e pasurive.
<b>16.</b>	<b>Mos deklarimi i tere pasurisë qe ka ne dispozicion Kuvendi i Kosovës</b> Zyrtaret përgjegjës për deklarim te pasurisë ne (PF) dhe ne Departamentin e Thesarit (Free Balanc), nuk e kane deklaruar te gjithë pasurinë qe e ka ne dispozicion Kuvendi i Kosovës, nga e gjithë pasuria e kuvendit te	Konstatojmë se Kuvendi i Kosovës nuk e ka prezantuar te gjithë pasurin ne pasqyra financiare, kjo mosparaqitje është ne kundërshtim me nenin 15.1 dhe nenin 1.1 te udhëzimit administrative 2005/11.	I rekomandojmë Menaxhmentit qe te veproje sipas udhëzimit administrativ 2005/11, neni 15.1 dhe 1.1 për paraqitjen e te gjithë pasurisë kapitale dhe jokapitale ne regjistra kontabël- Free Balance, dhe në pasqyrat financiare.

	Kosovës ne pasqyra financiare janë paraqiture vetëm 20 vetura. ku nga Personeli i kuvendit nuk janë deklaruar pasurit tjera te cilat vlera e tyre është mbi € 1000 dhe jetëgjatësia e tyre mbi 1 vite, siç janë: fotokopjet, laptopat ndërtesat , kompjuterët, dhe pajisje tjera te ndryshme		
<b>17.</b>	<b>Mos vlerësimi dhe mos zhvlerësimi i pasurisë</b> Gjate auditimit te rexhistrave te pasurisë kemi vërejtur qe regjistrat e këtyre pasurive përmbajnë vetëm emrin e pasurisë dhe sasinë, pra këto pasuri nuk përmbajnë vlerën, zhvlerësimin, dhe vitin e blerjes.	Këto regjistra nuk janë plotësisht te efektshëm për te paraqiture një gjendje te drejte te pasurisë te cilën munde ta ketë kuvendi i Kosovës, mosparaqitja e vlerës, zhvlerësimit dhe vitin e blerjes se pasurisë është ne kundërshtim me nenin 8.1 te udhëzimit administrative 2005/11	I rekomandojmë Menaxhmentit qe te përmbaje regjistrat kontabël te pasurisë ku ne këto regjistra përpos emërtimit te pasurisë te paraqitet edhe vlera e tyre, dhe ne baze te vlerëshmërisë te behet edhe zhvlerësimi i pasurisë ku këto rregulla janë te parapara ne nenin 8.1 te udhëzimit administrativ 2005/11.
	<b>7. Subvencionet dhe Transferet</b>		
<b>18.</b>	<b>Mos deklarimi i raporteve financiare nga Partitë Politike ne OSBE.</b> Nga 17 partitë politike te cilat i kanë anëtarë e tyre në Kuvendin e Kosovës, 6 prej tyre nuk kane dorëzuar asnjë raporte financiare për vitin 2006. 2 prej tyre kane dorëzuar vetëm për njëri periudhe te vitit 2006. LDK-ja nuk ka dorëzuar asnjë raport financiar për periudhën e dyte te vitit 2006. PD-ja nuk ka dorëzuar asnjë raporte financiar për vitin 2006.	Të gjitha partitë politike duhet t'i përmbahen nenit 19.1, a,b, te Rregullores 2004/11, qe këto parti duhet ti dorëzohen zyrës për çdo vite raporte gjashte mujore financiare.	I rekomandojmë Partive Politike qe ti përgatisin raportet e tyre financiare ne çdo 6 muaj t'i përmbahen në tërësi Rregullores 2004/11 nenin 19.1, a,b, për raportimet e tyre ne zyrën përkatëse te OSBE-se.
<b>19.</b>	<b>Mos prezantimi i sakte i te dhënave financiare ne raportet e partive politike</b> Disa parti politike kane paraqiture te dhënat financiare ne mënyre te përgjithshme duke mos bere ndarjen e tyre se cilat te hyra janë	Konstatojmë se disa parti politike nuk ju kane përmbajete ne tërësi nenit 19.2 te rregullores 2004/11 për paraqitjen e drejt te burimit te te hyrave dhe shpenzimeve te ndodhura për vitin	I rekomandohet partive politike qe ti përmbahen ne tërësi neni 19.2 përkatësisht nenit 20 te rregullores 2004/11 ku kërkohet qe këto parti te përmbajnë te dhëna te sakta dhe te

	nga BKK-es, (donacionet), e cilat si te hyra tjera, gjithashtu sipas komenteve te zyrës se OSBE-es, partitë politike nuk përmbajnë shënime te sakta dhe te hollësishme financiare për një periudhe 7 vjeçare.	2006, si dhe nenit 20 ku kërkohet qe partitë politike te përmbajnë shënime financiare te sakta dhe te hollësishme për një periudhe 7 vjeçare.	hollësishme te shënimeve financiare për periudhën 7 vjeçare, dhe te gjitha këto te dhëna te jene te paraqitura ne mënyre te drejte përmes, bilancit te gjendjes, pasqyrës se fitimit, dhe pasqyrës se çdo pagese te bere.
<b>20.</b>	<b>Personat joprofesional ne mbajtjen e shënimeve financiare</b> Ne baze te pohimeve te personelit te zyrës se OSBE-es dhe auditimit tone te cilën ne ju kemi bere këtyre raporteve financiare, konstatojmë se shumica e partive politike personat te cilët i kane te angazhuar si udhëheqës te financave janë joprofesional, ne punën e tyre.	Ne baze te nenit 18.3 zyra nuk duhet te pranoje raporte financiare te dorëzuara nga përfaqësuesi financiare i cili nuk ju ka përmbajete nenit 18.2 te rregullores 2004/11.	I rekomandohet zyrës se OSBE-es qe te mos pranoje asnjë raporte nga partitë politike te cilat nuk i përmbahen nenit 18.3 përkatësisht nenit 18.20 te rregullores 2004/11.
<b>21.</b>	<b>Mos aplikimi i gjobave nga zyra për partitë politike</b> Zyra për pranim te raporteve ne kuadër te OSBE- es nuk ka bere asnjë gjobitje ndaje partive te cilat nuk kane raportuar sipas afatit te parapare si dhe ndaje atyre partive qe nuk kane bere paraqitje te drejte te raporteve financiare.	Zyra pranë OSBES-es duhet te veproje ne harmoni me nenin 23 te rregullores 2004/11 për partitë politike te cilat nuk kane bere paraqitjen e drejte dhe me kohe te raporteve te tyre financiare.	I rekomandojmë zyrës për te gjitha ato parti politike te cilat nuk i përmbahen rregullores 2004/11, te veproje ne baze te nenin 23 po te kësaj rregullore për gjobitjen e tyre.
<b>22.</b>	<b>Mos kontrollimi i raporteve politike nga zyra e OSBE-es</b> Nga zyre kemi marre informacione se nuk ka bere asnjë kontroll nga revizoret për raportet financiare te partive politike,	Konstatojmë se zyra ne baze te nenit 21 te rregullores 2004/11 ka te drejte qe te beje kontrollimin me ane te revizoreve, çdo raporti financiare gjashte mujore qe e raporton partia politike.	I rekomandojmë zyrës qe ne afat sa me te shkurtër qe ti merre te gjitha hapat e mundshëm për te bere kontrollimin e çdo raporti financiar te partive politike siç kërkohet ne baze te nenin 21 te rregullores 2004/11.

9. Aneksi 2		
Nr.	Komentet e Kuvendit te Kosovës	Komentet e auditorëve
1.	Në pjesën e parë të tekstit, pasusi i dytë, mes të tjerash thuhet: "Pjesa më e madhe e paqartësive rrjedh nga pagesa e partive politike për të cilat raportet financiare nuk kanë qenë të përgatitura në mënyrë adekuate". Ju kemi bërë me dije se rekomandimet me nr. 18-22 janë një angazhim shtesë i Kuvendit dhe se partitë politike raportojnë për menaxhim të mjeteve në OSBE. Andaj, kërkojmë që në Raportin final të ndahen rekomandimet që kanë të bëjnë me Kuvendin e Kosovës nga rekomandimet që kanë të bëjnë me rekomandimet e partive politike.	<b>Mbesin konstatimet ne raport.</b>  Ne kemi konstatuar ne raport se shpenzimet e mjeteve për partitë politike nuk menaxhohen nga Kuvendi i Kosovës, pore ato mjete alokohen çdo 3 muaj nga kuvendi i Kosovës dhe i shpërndahen partive politike. Ne raport janë te paraqiture ndaras rekomandimet e partive politike me ato te Kuvendit te Kosovës.
2.	Në faqen 6, pasusi i fundit, mes të tjerash kemi një konstatim se "te gjeturat janë ilustrime të çështjeve kyçe që janë gjetur. gjatë auditimit të KK, por që nuk duhet të merren se mund të shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit". Ky formulim është i paqëndrueshëm, sepse, nëse ilustrimet e çështjeve kyçe që janë gjetur nuk mund të merren se mund të shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit, shtrohet pyetja se çfarë paraqesin ato ilustrime. Pra, ky tekst nuk duhet të gjejë vend në Raportin final.	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Kjo është procedurë standarde qe përdoret gjate procesit te auditimit si dhe ne raportin e auditimit, mirëpo për këtë konstatojmë qe auditorët asnjëherë nuk munde te japin siguri absolute për punën te cilën e kryejmë.
3.	Në faqen 8, pasusi i dytë, teksti: "Ka shumë çështje serioze sa i përket menaxhimit të pasurive." nuk shpjegon të gjeturat konform termit të përdorur "serioze", sepse kemi regjistrimin e gjithë pasurisë së Kuvendit në sasi, por që ju mungon vlera dhe shkalla e amortizimit. Pra, nuk është e regjistruar komplet me vlerë, por është e regjistruar komplet në sasi dhe strukturë. Andaj, në Raportin final, fjala "serioze" do të duhej të zëvendësohej me fjalën "jokomplete".	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Këto te gjetura i kemi paraqiture ne aneksin 1 shtese ne raportin final.
4.	Në faqen 9, pasusi i parafundit ka një konstatim që bie ndesh me raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili ka ushtruar kontroll gjatë vitit 2006 dhe, me shkresën nr. 1522, të datës 05.09.2006, ndër të tjera thuhet: "Në zyrën e personelit gjinden të gjitha dosjet e nëpunësve, emërimeve, komisioneve, konkurseve,	<b>Mbesin konstatimet ne raporte</b>  Mostrat e audituara tregojnë një gjendje tjetër. Ne e japim opinionin tone ne baze te auditimit qe e kemi kryer.

	ankesave, etj., të cilat janë të vendosura në bazë të procedurave të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë. Andaj, do të duhej që konstatimi i ZRGJ-së në Raportin final të hiqet në tërësi.	
5.	Në faqen 11, pasusi i dytë, ndër të tjera thuhet: "Ekzistojnë disa shkelje të LPP-së, të cilat shpjen në paqartësi dhe gabim financiar". Është ky një konstatim i cili do të duhej të definohej si paqartësi, por kurrsesi si gabim financiar, ngase nuk është gabuar asgjë në aspektin financiar. Pra, në Raportin final nuk do të duhej të përdorej fjala gabim, ngase nuk kemi të bëjmë me asnjë gabim financiar.	<b>Mbesin konstatimet ne raporte</b>  Pjesa ma e madhe e shkeljeve ka te beje me paqartësi mirëpo, te pagat dhe mëditjet kemi te bëjmë me një vlere te vogël ku ka te beje edhe me gabime financiare.
6.	Në faqen 14, pika 8, ndër të tjera, thuhet se nuk keni marrë dëshmi me shkrim për masat që kanë të bëjnë me implementimin e rekomandimeve të auditorëve për vitin 2005. Duhet theksuar se, lidhur me Auditimin e të gjeturave faktike për vitin 2005, në Kuvendin e Kosovës kanë qenë të njoftuara të gjitha institucionet e Kosovës: ' Përmes shqyrtimit të raportit në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës (transmetim direkt televiziv për opinion), Përmes formimit të Komisionit hetimor për stafin politik, për verifikimin e të gjeturave faktike, Përmes njoftimit të Prokurorisë së Qarkut me rekomandimet e Komisionit hetimor dhe me Vendimin e Komisionit disiplinor për masat e shqiptuara për zyrtarët civilë, Përmes formimit të Komisionit disiplinor për stafin civil, lidhur me të gjeturat faktike dhe njëkohësisht përmes shqiptimit të masës ndërprerje e marrëdhënies së punës për ish-sekretarin, drejtorin e Departamentit të buxhetit dhe financave, udhëheqësin e Divizionit të prokurimit dhe zyrtarin për Furnizim. Të gjitha këto aktivitete kanë qenë të prezantuara në ueb-faqe të Kuvendit të Kosovës, por edhe në të gjitha mediumet elektronike dhe në të shkruara	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Nuk kemi marre dëshmi me shkrim që do ta mbështesnin implementimin e rekomandimeve për vitin 2005 nga Kuvendi i Kosovës .
	Kuvendi i Kosovës deri më 04 qeshor 2007 tash nuk ka pasur të punësuar Zyrtar të pasurisë, punët e tij janë kryer nga një zyrtar në kuadër të Departamentit për buxhet dhe financa. Sekretari i Kuvendit, më 04.06.2007, ka ngarkuar një punëtor me detyrat e Zyrtarit të Pasurisë. Po ashtu, konform nenit 3.2, Sekretari i Kuvendit, me	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Entiteti është pajtuar me te gjeturat e paraqitura ne raport.

7.	vendimin e datës 04.06.2007, ka themeluar Komisionin për vlerësimin e pasurive.	
8.	<b>Sistemi i kontrollit të brendshëm</b>  Kuvendi i Kosovës nuk e ka themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm. Kryesia ka nxjerre rregulloren e re, ku menjëherë pas këtij miratimi është shpallur konkursi sipas te cilit se shpejti do te behet plotësimin edhe i këtij pozicioni.	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Entiteti është pajtuar me te gjeturat e paraqitura ne raport.
9.	<b>Pagat dhe Mëditjet, mosrespektim I kodeve ekonomike</b>  Në këto kode janë kërkuar dhe janë lejuar mjete nga MEF-i, nuk ka pasur ndonjë kod tjetër në të cilin kanë mundur të mbulohen këto shpenzime, dhe asnjëherë nga MEF-i nuk është bërë ndonjë vërejtje për këtë çështje. Ne mendojmë se këtu nuk është bërë asnjë shkelje.	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Kodet e shfrytëzuara për këto shpenzime nuk kane te bëjnë me këtë lloje te shpenzimeve. K.K-es duhet te kërkojë nga MEFi (Thesarit) kode adekuate për këto shpenzime.
10.	<b>Mos aplikimi i shkallëve tatimore</b>  Shkalla e duhur tatimore është paguar në paga ngase ato janë të rregullta dhe fikse. Ndërsa, shkalla tatimore në shtesa është e ndryshme nga muaji në muaj, pasi shtesat nuk janë fikse dhe, me këtë rast, ka ardhur deri te pasqyra se nuk është aplikuar gjithmonë shkalla e njëjtë tatimore dhe kemi një tatim të paguar në vlerën e cila do të kompensohet menjëherë.	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Entiteti është pajtuar me te gjeturat e paraqitura ne raport.
11.	<b>Pushimet mjekësore</b>  Është fakt se gjatë vitit 2006 kemi pasur dy raste në të cilat nëpunësve i është lejuar pagesa e pushimit mjekësor për periudhën më të gjatë se 15 ditë. Rasti i parë ka të bëjë me punëtoren, e cila kishte probleme serioze shëndetësore për shkak të lëndimit të gjurit gjatë ecjes, dhe me këtë rast pati edhe shpenzime të mëdha lidhur me terapinë Me kërkesën e saj që t'i ndihmohet në përbalimin e shpenzimeve të krijuara me atë rast Sekretari i Kuvendit i lejoi pagesën e plotë të pagës mujore Rasti i dytë ka të bëjë me një zyrtare tjetër, e cila kërkon që t'i mundësohet pagesa e plotë për pushimin mjekësor 5 ditë më të gjatë se 15 ditët e parapara, kjo punëtore kërkoi që t'i lejohet ky	<b>Mbesin konstatimet ne raport</b>  Entiteti është pajtuar me te gjeturat e paraqitura ne raport.

	<p>tejkalim meqenëse kishte probleme serioze shëndetësore dhe se për 6 vite, sa është në marrëdhënie pune, asnjëherë nuk kishte pasur tejkalim të pushimit mjekësor. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të mëdha që kishte lidhur me terapi në, të njëjtës, nga drejtori i Administratës, i lejohet pagesa e plotë e pagës. Lidhur me konstatimin se kishte konfuzion në disa raste (me çka ne nuk pajtohemi, meqë nuk është adekuat termi konfuzion), sqarojmë se në Seksionin e personelit mbahen dosjet personale të nëpunësve në pajtim me Udhëzimin administrative Nr. MSHP/DASHC 2003111, përveç se të dhënat që kanë të bëjnë me rekrutimin (konkursi, intervista, paneli, etj.) dhe dosjet disiplinore. Për shkak të vëllimit që përmbajnë këto dosje, është e pamundshme të jenë fizikisht të vendosura në një dosje të vetme, por ekzistojnë dosje të veçanta, të ndara fizikisht.</p>	
12.	<p><b>Furnizim me inventar për zyre</b></p> <p>Është fakt se, operatori, për shkak të disa problemeve në transport, ka vonuar t'i përmbush disa pika të kontratës, mirëpo e ka njoftuar Zyrën e prokurimit. Pastaj, edhe ne kushtet e përgjithshme të kontratës, është paraparë që, nëse ndodh ndonjë vonesë, operatori duhet ta njoftojë autoritetin kontraktues, gjë të cilën e ka bërë. Pasi është përmbushur projekti, Kuvendi i Kosovës e ka kryer pagesën, ku, me këtë vonesë, Kuvendit nuk i është shkaktuar ndonjë dëm ekonomik.</p>	<p><b>Mbesin konstatimet ne raport</b></p> <p>Entiteti është pajtuar me te gjeturat e paraqitura ne raport.</p>
13.	<p><b>Furnizim me pajisje te teknologjisë informative</b></p> <p>Me qen se me aplikimin e procedurës se Freebalance nga MEF-ev deri pas vitit 2006 nuk ka pasur procedure tjetër te aplikimit te urdhërpagesave, është dashure te veprohet siç është vepruar ne te gjitha institucionet e tjera ne Kosovë.</p>	<p><b>Mbesin konstatimet ne raport</b></p> <p>Këto te gjetura i kemi paraqiture ne aneksin 1 shtese ne raportin final.</p>
14.	<p><b>Sigurimi I automjeteve për Kuvendin e Kosovës</b></p> <p>Për arsye të mungesës së stafit të mjaftueshëm të prokurimit, menaxheri i prokurimit ka qenë i detyruar të caktojë komisionin e hapjes dhe të vlerësimit nga të njëjtit anëtarë. Procedura e hapur, afatet normale kohore të vlerës së mesme dhe të gjitha procedurat kanë qenë të aplikuara konform rregullave dhe procedurave të</p>	<p><b>Mbesin konstatimet ne raport</b></p> <p>Qe te mos kemi konflikt te interesave dhe ndarje te duhure te detyrave udhëheqësi i prokurimit duhet ta ndajë komisionin e hapjes nga ai i vlerësimit.</p>



	parapara të LPP 2003/17.	
<b>15.</b>	<p><b>Furnizimi me material për zyre</b></p> <p>Në këtë kohë është punuar me instruksione administrative për prokurim dhe limitet (vlerat) e procedurave të caktuara kanë qenë të ndryshme me procedurat të cilat i aplikojmë tani sipas LPP 2003/17, i cili ka filluar të aplikohet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2006.</p>	<p><b>Mbesin konstatimet ne raport</b></p> <p>Kuvendi i Kosovës duhet ta zbatojë Ligjin e Prokurimit Publik prej datës se hyrjes në fuqi.</p>
	<b>Mallra dhe shërbime</b>	
<b>16.</b>	<p><b>Moszbatimi I kodeve ekonomike</b></p> <p>Në kodin 13140 - "Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit" janë buxhetuar mjetet për të gjitha shpenzimet për udhëtime jashtë vendit, përfshirë edhe pagesën e biletave të udhëtimit ndërsa, në listën e kodeve ekonomike të përgatitura nga MEF-i, ky kod është i përcaktuar për udhëtime jashtë vendit, nga i cili i kemi paguar edhe biletat për udhëtime zyrtare jashtë vendit.</p>	<p><b>Mbesin konstatimet ne raport</b></p> <p>Entitetit duhet t'i zbatojë kodet ekonomike përkatëse.</p>
<b>17.</b>	<p><b>Mirëmbajtja dhe pastrimi I objektit te Kuvendi te Kosovës</b></p> <p>Neni 57 i LPP 2003/17, i cili nga auditorët për mosrespektim, thotë: ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Këtë nen, autoriteti, gjegjësisht Kuvendi I Kosovës, ne tërësi e ka aplikuar.</p>	<p><b>Pranohet komentit nga Kuvendi i Kosovës</b></p> <p>Ne këtë pike ne kemi cekure që mungon nënshkrimi i komisionit për vlerësim të ofertave, mirëpo ne fakte mungon data e komisionit për vlerësimin e ofertave.</p>
<b>18.</b>	<p><b>Mos mbyllja e avancave</b></p> <p>Sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, nr. 02-2707-1/06, të datës 9 nëntor 2006, u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel, prej datës 26 deri më 29 nëntor 2006, anëtarëve të Komisionit për Komunitete dhe Kthim.</p> <p>Nga 9 deputetë, sa kanë shkuar në udhëtim zyrtar, 4 prej tyre i kanë sjellë faturat e fjetjes.</p> <p>Të gjithë deputetët kanë qenë të njoftuar me rastin e marrjes së avancit se të gjitha shpenzimet e fjetjes duhet të mbulohen me fatura.</p>	<p><b>Mbesin Konstatimet ne raport</b></p> <p>Entiteti është pajtuar me të gjeturat e paraqitura ne raport.</p>

<p><b>19.</b></p>	<p><b>Pagesa me e madhe për vizita jashtë shtetit pa ndonjë vendim shtese</b></p> <p>Me 27 shkurt 2006, njëri nga deputetet e K. Kosovës, ka tërhequr avancë nga Kuvendi ne vlere 1,465.60 € Pas kthimit nga udhëtimi, ky deputet ka kërkuar se i takon udhëtimi edhe për dy dite shtese. Ne zyrën e drejtorit te buxhetit është dorëzuar një shkresë (ftesa për pjesëmarrje ne takime zyrtare ne Rio De Janerio te Brazilit). E njëjta kërkesë është edhe me herët por vetëm datat ndryshojnë: shkruan data e ftesës prej 27 shkurt deri me 7 mars 2006.</p>	<p><b>Mbesin Konstatimet ne raport</b></p> <p>ZAP-i nuk ka marrë dëshmi që mbështet në pohimin e KK-së.</p>
<p><b>20.</b></p>	<p><b>Mos deklarimi I tere pasurisë qe ka ne dispozicion Kuvendi I Kosovës</b></p> <p>Lidhur me te gjeturat nen numrin rendor 16 te auditorit gjeneral kemi ketë koment si ne vijim: Është e vërtet qe janë paraqiture gjithsej 20 automjete si pasuri e Kuvendit te Kosovës, gjë qe është gjendje faktike. Dy automjete e tjera, te cilat përmenden ne ketë pike, nuk janë prone e Kuvendit te Kosovës, për arsye se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Automjeti Chevrolet Sudurban, me numër te shasisë 3GNGK26G25G101270, ESHTË PRONE E Zyrës se Kryetarit te Kosovës, e cila sipas kontratës ndërmjet te Zyrës se Kryetarit te Kosovës dhe te Kuvendit te Kosovës, te nënshkruar nga drejtoret e Administratës se këtyre dy institucioneve, automjet I është dhënë Kuvendit te Kosovës ne shfrytëzim për nevoja te Kryetarit të Kuvendit të Kosovës.</li> <li>- Automjeti tjetër i tipit Mercedes Benz C180, me numër të shasisë WDB203035-1F-262931, Kuvendit të Kosovës i është dhënë në shfrytëzim prej Ministrisë së Shërbimeve Publike sipas marrëveshjes së arritur në mes të Administratës së Kuvendit të Kosovës dhe Administratës së Ministrisë së Shërbimeve Publike, të nënshkruar më 3 tetor 2002, nga drejtori i Administratës së Kuvendit të Kosovës dhe Shërbimit Qendror të Prokurimit në Ministrinë e Shërbimeve Publike.</li> </ul>	<p><b>Mbesin konstatimet ne raporte</b></p> <p>Nuk behet fjale vetëm për dy vetura qe nuk i ka deklaruar kuvendi ne pasqyra financiare, behet fjale për pasurinë te cilën e ka mbi 1000 €dhe jeta e përdorimit te tyre është mbi 1 vite, qe nuk e ka deklaruar ne pasqyra financiare.</p> <p>ZAP-i i pranon komentet për dëshmitë e ofruara nga Kuvendi i Kosovës për dy vetura qe nuk janë prone e Kuvendit te Kosovës, edhe pse gjate auditimit ekipit të auditimit nuk iu janë ofruar dëshmi të tilla.</p>
<p><b>21.</b></p>	<p><b>Mos deklarimi i raporteve financiare nga partitë politike ne OSBE</b></p>	<p><b>Pranohet komenti nga Kuvendi i Kosovës</b></p>

	<p>Administrata e Kuvendit të Kosovës e kryen vetëm punën teknike për partitë politike. Partitë politike i raportojnë OSBE-së. Ne kemi qasje vetëm në ndarjen e mjeteve (alokimin dhe zotimin e tyre), sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, por jo edhe në shpenzimet dhe raportet e tyre. (Sqarim nga rekomandimi i Auditorit: prej numrit rendor 18 deri në numrin rendor 22).</p>	<p>Këto të gjetura kanë të bëjnë me mjetet e BKK-së për partitë politike.</p>
--	---	---